


FOLIE AVULL LËSHUESE M120



Membranë me difuzion të lartë për nënçati, montohet drejtpërdrejtë në termoizolim (konstrukt dyshtesor i çatisë pa sfond të drurit, fasadë termoizoluese me ventilim)

Përdorimi:

Skajin e membranës kombinojeni me kapakët në skajet e çatisë. Membrana me kapakët ngjitet me shirit ngjitës nr. art. 1681500. Membrana montohet ashtu që sipërfaqja e printuar me vija të jetë e kthyer kah tjegullat. Renditja (bashkimi) bëhet sipas vijave të printuara për bashkim (tegël), lidhjet vertikale ngjiten mbi tra. Distanca maksimale mes trarëve është 100cm. Këndi minimal i pjerrtësisë së kulmit është 17°, ndërsa për kulmet me pjerrtësi <22° vendbashkimet i ngjiten me shirit ngjitës nr. art. 1681500. Nëse këndi i pjerrtësisë së kulmit është më i vogël se këndi i tjegullave, atëherë bashkimin ngjiteni me shirit ngjitës nr. art. 1681500. Dëmtimet mekanike riparohen me copëza të membranës dhe me shirit ngjitës. Që të sigurohet mbrojtje nga fryrja e erës, bashkimet e membranës duhet ngjitur me shiritin ngjitës nr. art. 1681500. Termoizolimi montohet ashtu që të pamundësojë ngritjen e membranës. Pas montimit të membranës, mbulimi me tjegulla të bëhet më së largu 3 muaj nga data e montimit. Rrotullat (rollnet) duhen magazinuar horizontalisht, në sipërfaqe të pastër dhe të rrafshët, të mbrojtura nga rrezatimi UV.

Të dhënat teknike	
Pesha	120 g/m ² (± 10%) sipas EN:1849
Qëndrueshmëria në grisje	180/120 (± 20%) sipas EN 12311-1
Rezistenca ndaj ujit	W1 sipas EN1928-2002
Lëshimi i avullit	0,02 SD (-0,005, +0,015) sipas EN 1931, EN12572
UV stabiliteti	3 muaj
Stabiliteti në temperatura të ulëta	- 40°C

Emërtimi	Pesha g/m ²	Gjatësia m	Gjerësia m	Nr.Art.	Paketimi m ²
M120	120	50	1.5	3681100120	75

